



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

Nr. 08 Prot.

Vlorë, më 05.01.2021

VENDIM

Nr. 26, datë 28.12.2020

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË RE “PËR PARANDALIMIN E
KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE
PUBLIKE”**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë . .2020 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 46 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9048, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, akteve nënligjore të miratuar në bazë të tyre si dhe në Vendimin e Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 51, datë 29.12.2005 “Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”,

VENDOSI;

1. Të miratojë Rregulloren e re “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Sektori i Urbanistikës, Zhvillimit të Territorit, Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Çështjeve Sociale në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Ky Vendim hyn në fuqi sipas pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.